

AKT - THEMELIMI
I SHOQERISE "ONUFRI" SH.P.K. ELBASAN

Shoqëria "ONUFRI" SH.P.K. themelohet lirisht nga shtetasi

BUJAR HUDHRI, i biri Ramazanit, datëlindja 14 Maj 1956, lindur e banues në Elbasan, lagja Qemal Stafa, pallati 25.

Shoqëria "ONUFRI" në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar do të zhvillojë aktivitetin e sajë në bazë të ligjeve nr. 7512 datë 10.08.1991, nr.7638 datë 19.11.1992, nr. 7764 datë 2.11.1993. Shoqëria pasi të ketë bërë rregjistrimin në GJYKATËN E RRETHIT TIRANË do të veprojë si person juridik me të drejta të plota me mjetet financiare e materiale të disponueshme e të deklaruara përpara autoriteteve kompetente shqiptare.

Objekti i veprimtarisë tregtare i shoqërisë "ONUFRI" SH.P.K. do të jetë :
Shtëpi botuese, shtypshkronjë, eksport- import të materialeve të ndryshme, shitje me shumicë dhe me pakicë.

Akti bazë në të cilin shoqëria do të mbështesë veprimtarinë e saj është statuti në të cilin përcaktohet forma e shoqërisë, afatet, qëllimet, kapitali, forma e organizimit, drejtimit dhe administrimit të cilat janë të detyrueshme si për themeluesit e kësaj shoqërie ashtu edhe për raportet e ortakërisë që mund të pasojnë në jetëgjatësinë e kësaj shoqërie. Akti i themelimit bashkëngjitet me statutin i cili në përmbajtjen e tij plotëson qëllimet e këtij akti.

Kapitali social i shoqërisë është 100 000 (njëqindmijë) lekë.

Kapitali social i shoqërisë është ndarë në 100(njëqind) kuota, me 1000 (njëmijë) secila kuotë.

Pronari i shoqërisë "ONUFRI" SH.P.K. zoti Bujar Hudhri zotëron tërësisht kapitalin e shoqërisë me 100 (njëqind) kuota.

Administrator i vetëm i shoqërisë "ONUFRI" SH.P.K. është zoti Bujar Hudhri.



Selia e shoqërisë do të jetë në qytetin e Elbasanit, lagja "Qemal Stafa", Shtëpia Botuese "ONUFRI".

SHOQËRIA "ONUFRI" SH.P.K. ELBASAN

Pronari
BUJAR HUDHRI

[Handwritten signature of Bujar Hudhri]



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT

NOTERIA

Nr. 849 Rep
349 Kol

TIRANE

më 21.2.1995

VERTETIM

Unë, noteria Pranvera Karafili, vërtetoj se përpara meje u paraqit personalisht Z.Bujar Hudhri i cili pasi u identifikuan nga ana ime dhe rezultuan që është në moshë madhore dhe i aftë për të kryer veprime juridike, deklaroi se është dakort me përmbajtjen e aktit të mësipërm dhe e nënshkroi këtë akt me vullnet të lirë e pa hezitim në praninë time.

NOTERIA
PRANVERA KARAFILI

[Handwritten signature of Pranvera Karafili]



S T A T U T
I SHOQERISE "ONUFRI" SH.P.K.ELBASAN



Shoqëria private "ONUFRI" SH.P.K. Elbasan, themelohet lirisht nga shtetasi shqiptar :

BUJAR HUDHRI, i biri i Ramazanit, datëlindja 14 Maj 1956, lindur e banues në Elbasan, lagja "Qemal Stafa", pallati 25.

Shoqëria në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar do të zhvillojë aktivitetin e sajë në bazë të ligjeve nr.7512 datë 10.08.1991, nr.7638 datë 19.11.1992, nr.7764 datë 02.11.1993. Shoqëria pasi të ketë bërë regjistrimin në gjykatën e Tiranës do të veprojë si person juridik me të drejta të plota, me mjetet financiare e materiale të disponueshme e të deklaruara përpara autoriteteve kompetente shqiptare.

NENI 1

Shoqëria "ONUFRI" SH.P.K. Elbasan ka për objektiv të veprimtarisë së sajë: Shtëpi botuese, shtypshkronjë, eksport-import të materialeve të ndryshme, shitje me shumicë dhe me pakicë.

NENI 2

Shoqëria mund të kryej të gjitha operacionet tregtare, industriale, lëvizjet e vlerave të rrjedhura nga pasuritë e tundëshme e të patundëshme të konsiderueshme për objektin social. Shoqëria ka selinë në qytetin e Elbasanit, me adresë lagja "Qemal Stafa", pallati 25 dhe ka të drejtë të hapë agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë e jashtë shtetit.

NENI 3

Strehimi i ortakëve në raport me shoqërinë është ai i fundit në rend kohor i komunikuar shoqërisë.

NENI 4

Kohëzgjatja e shoqërisë është fiksuar deri më 31.12.2020 dhe mundet të zgjatet nga asambleja e ortakëve sipas afateve të ligjit.

NENI 5

Kapitali social i shoqërisë është fiksuar në 100 000 (njëqindmijë) lekë i ndarë në 100 (njëqind) kuota me nga 1000 (njëmijë) lekë seicila kuotë. Kapitali social është tërësisht i shlyeshëm.

Pronari i shoqërisë "ONUFRI" SH.P.K. Z.Bujar Hudhri mban në pronësi tërësisht kapitalin e shoqërisë, të përbërë nga 100 (njëqind) kuota.



NENI 6

Transferimi i kuotave duhet të realizohet sipas normave të parashikuara nga nenet nr.45, 46, 47, 49 të ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare".

NENI 7

Mbledhjet e asambleve thirren nga këshilli i administrimit ose nga eksperti kontabël i autorizuar nga një ose më shumë ortakë që përfaqësojnë të paktën 10 % të kapitalit social.

NENI 8

Thirrja bëhet me shkrim me letër të rekomanduar që duhet të arrijë tek ortakët të paktën 30 ditë përpara mbledhjes. Letra e thirrjes duhet të përmbajë vendin, ditën e orën e mbledhjes si dhe rendin e ditës, gjithashtu duhet të përmbajë vendin, ditën e orën e mbledhjes së dytë në rast se në mbledhjen e parë nuk është e mundur të arrihet shumica e nevojshme.

NENI 9

Asambleja drejtohet nga kryetari i këshillit të administrimit ose nga një ortak i zgjedhur nga asambleja i ndihmuar nga një sekretar i emëruar.

NENI 10

Çdo ortak ka aq vota sa janë dhe kuotat e kapitalit që zotëron. Çdo ortak mundet të përfaqësohet në asamble nga një ortak tjetër ose nga një person i tretë i besuar, përveç administratorëve.

NENI 11

Ndryshimet në statut aprovohen me ato vota që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e kapitalit social, për vendimet e tjera të asamblesë janë të nevojshme votat e një ose më shumë ortakëve që përfaqësojnë të paktën 70 % të kapitalit social në thirrjen e parë dhe shumicën e votave të ortakëve të pranishëm në thirrjen e dytë. Për konsultimet me shkrim kërkohet mendimi i favorshëm i të gjithë ortakëve. Në rast të mungesës së përgjigjes brenda ditës së 20 nga data e marrjes së kërkesës së shkruar konsiderohet si i shprehur mendimi i favorshëm. Vlejnë në këtë rast edhe normat e kërkesës së dytë siç parashikohet nga neni nr.59 i ligjit "MBI SHOQERITE TREGETARE"

NENI 12

Në rast ndryshimesh të ligjit që kërkojnë një përshtatje të statutit këshilli i administrimit do të përcaktojë pa vonesë në thirrjen e asamblesë së ortakëve.

NENI 13

Vendimet e asamblesë aprovohen me modalitetet e herëpashërëshme të përcaktuara nga kryetari i asamblesë. Vendimet e asamblesë të marra konform ligjit e statutit lidhin të gjithë ortakët edhe nëqoftëse nuk janë prezent ose nuk janë dakort. Në asnjë rast shumica nuk mundet të detyrojë një ortak të shtojë pjesën e tij të kapitalit social.

NENI 14

Shoqëria administrohet nga këshilli i administrimit anëtarët e të cilit mundet të mos jenë dakort ose mundet të mos jenë ortakë. Numuri i tyre përcaktohet herëpashere nga asambleja. Në rast të emërimit të një administratori të vetëm ai do të marrë përsipër kompetencat totale të këshillit të administrimit dhe të kryetarit të tij. Administratorët rrinë në detyrë për të kryer detyrat sociale dhe mundet të shkarkohen në çdo kohë. Këshilli i administrimit emrohet në aktin e themelimit. Ndërmjet anëtarëve të tij këshilli i administrimit zgjedh kryetarin e tij.

NENI 15

Këshilli i administrimit ka të gjitha kompetencat për administrimin e shoqërisë në kufijtë e objektit social dhe ato që ligji dhe statusi i rezervojnë asamblesë. Këshilli i administrimit mundet ndërmjet gjërave të tjera të blejë e të shesë, të shkëmbejë pasuritë e tundëshme e të patundëshme, të japë në shoqëri të tjera të themeluara ose që janë duke u themeluar, të marrë përsipër qëllime sociale, të marrë kredi duke i garantuar me hipotekë, të japë lejen në fshirjen hipotekare mbi pasuritë e shoqërisë, të kryej marrveshje të leverdisëshme, të autorizojë dhe të kryejë çdo operacion në zyrat publike e private e në veçanti në banka.

Këshilli i administrimit mundet t'i delegojë një antari të tij detyrat e një administratori të zakonshëm për një sektor specifik (Këshilltar i deleguar) ose për të gjithë aktivitetin (administrator i deleguar). Kufijtë e shpenzimeve dhe të kompetencave do të vendosen nga këshilli i administrimit në aktin e emërimit. Këshilli i administrimit ka të drejtën të emërojë drejtor dhe prokurator për aktet e përcaktuara ose kategori aktesh.

NENI 16

Asambleja e ortakëve ka përfaqësim ligjor të shoqërisë përballë të tretëve në gjykim dhe të drejtën që të ndërmarrë masat e nevojshme sipas rastit dhe kërkesat gjyqësore e administrative për çdo shkallë gjykimi, revokimi e kasacioni dhe të emërojë për këtë avokatët, prokuratorët për grindjet. Këshillit të administrimit i takon kthimi i shpenzimeve të kryera në shërbim të detyrave të tij. Asambleja mundet t'i caktojë një shpërblim vjetor.

NENI 17

Këshilli i administrimit thirret nga kryetari me iniciativë të tij dhe me kërkesën e një antari të tijë. Për vlefshmërinë e vendimeve të këshillit të administrimit kërkohet prania e shumicës së administratorëve. Vendimet merren me shumicë absolute, në rast të barazimit të votave mbizotëron vota e kryetarit.

NENI 18

Asambleja mundet të emërojë një këshill administrimi kur të paktën janë dy ortakë. Në rast të një ortaku të vetëm do të ketë një administrator të vetëm.

NENI 19

Eshtë kompetencë e asamblesë së ortakëve :

- a) Aprovimi i bilancit vjetor.
- b) Emërimi i një ose më shumë ekspertëve kontabël të autorizuar.
- c) Aprovimi i një rregulloreje të brendëshme dhe i strukturës organizative.

- d) Emërimi i këshillit të administrimit.
- e) Aprovimi i ndryshimeve në statut.
- f) Kufizimi i kompetencave të administratorëve dhe autorizimi i operacioneve që kalojnë kufijtë e përmendur.
- g) Të vendosë likuidimin e shoqërisë.
- h) Emërimi i likuidatorëve.
- i) Aprovimi i llogarive rrjedhëse.

NENI 20

Ushtimet sociale mbylLEN në 31 djetoR të çdo viti. Këshilli i administrimit përgatit bilancin dhe dokumentat relative brenda 31 Marsit të çdo viti në mënyrë të tillë që të lejojë aprovimin nga ana e asamblesë së ortakëve brenda datës 30 Prill. Për të lejuar detyrimet e parashikuara nga ligji nr.7661 datë 19.01.1993 për kontabilitetin. Bilanci, llogaritë e fitimeve dhe të humbjeve si dhe raporti mbi shoqërinë duhet të kopjohet me zell dhe me respektimin e ligjeve në fuqi.

NENI 21

Fitimet neto, pasi i hiqet një shumë jo më e vogël se 5% e rezervës ligjore të domosdoshme i atribuohet kapitalit përveç rastit kur asambleja vendos formimin e rezervave speciale ose shpërndarjen e shumës ortakëve.

NENI 22

Pagimi i dividendeve kryhet në mënyrat e afatet e përcaktuara nga këshilli i administrimit dhe sidoqoftë brenda dy muajve mnga dita e vendimit të asamblesë.

NENI 23

Asambleja e ortakëve mundet në se e kërkon ligji të emërojë një ose më shumë ekspertë kontabël të autorizuar për një periudhë prej 6 vjetësh fiskalë në kufijtë e parashikuar nga nenet 168 e 169 të ligjit "MBI SHOQERITE TREGETARE" të cilat do të veprojnë sipas afateve të ligjit të mësipërm.

NENI 24

Përveç rastit të likuidimit gjyqësor, duke vendosur në çfardo kohe ose për çfarëdo motivi për shkrirjen e shoqërisë, asambleja do të emërojë një ose më shumë likuidues duke i përcaktuar kompetencat e kompensimet.

NENI 25

Të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së asamblesë që duhet të aprovojë llogaritë sociale, këto llogari do të jenë në dispozicion të ortakëve në selinë e shoqërisë.

Këshilli i administrimit do të përcaktojë rregullat operative për ti bërë të mundur ortakëve konsultimin e librave e llogarive sociale të paktën dy herë në vit.

NENI 26

Çdo mosmarrveshje që do të lindë ndërmjet ortakëve apo ortakëve dhe administratorëve do t'i ngarkohen apo jepen një këshilli arbitrues i përbërë nga tre anëtarë nga të cilët dy të emëruar nga gjykata e rrethit Tiranë. Arbitrat do të gjykojnë përfundimisht konfliktin e hapur në shoqëri.